

FLAMURI PA YLLIN KOMUNIST

Një nga çastet më kulmore të revoltës së Spaçit ishte ngritja e flamurit pa yllin komunist. Kjo ndodhte për herë të parë pas gati 30 vitesh të regjimit dikatorial. Sipas dëshmitarëve flamuri u ngrit gjatë mesnatës, duke gdhirë 22 maji i vitit 1973. Për përgatitjen e tij, të dënuarit politikë morën një beze të kuqe dhe më pas njëri prej tyre, Mersin Vlashi, pikturoi shqiponjën sipas modelit në një kuti duhani. Flamuri u bë qendra e fjalimeve, vjershave dhe qëndresës antikomuniste së rreth 600 të dënuarve që u përfshinë në revoltë.



Kutia e duhanit që shërbeu si model për shqiponjën që u vizatua në flamurin e revoltës së Spaçit. Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.

SHPJEGIME

Punë e detyruar – Çdo punë ose shërbim që i kërkohet një individ i nën kërcënimin e çfarëdo dënimi dhe për çka individ i në fjalë nuk është treguar vetë i gatshëm me dëshirën e tij të plotë. (Sipas Udhëzuesit të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut)

Agjitacion dhe propagandë – Është neni që dënonte me heqje të lirisë nga 3 deri në 10 vjet, çdo njeri që bënte agjitacion dhe propagandë që përmbante thirrje për të minuar ose dobësuar pushtetin popullor si dhe përgatitjen, përhapjen ose ruajtjen për përhapje e shkrimeve me përmbajtje e tillë. Kur këto vepra kryheshin në kohë lufte ose kishin shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, dënoheshin me heqje të lirisë jo me pak se 10 vjet ose me vdekje kurdoherë me konfiskim të pasurisë. (Sipas nenit 73 të ligjit 1470/1952).

Punëtori operativ – Është punonjësi që ka qenë në marrëdhënie pune, i cili ka patur funksione zyrtare në strukturën e Ish-Sigurimit të Shtetit. (Sipas nenit 3, pika 4.1 e Ligjit 45/2015 i ndryshuar).

Nga viti 1968 deri në vitin 1990, rreth 2000 të dënuar dhe të ridënuar kanë punuar në kampin e Spaçit. Nga shfrytëzimi i punës së tyre janë prodhuar në këto vite, 2.82 milionë ton bakër dhe 1.3 milionë ton pirit.

“Unë thashë: -Që t’i japim një kuptim të plotë politik kësaj që po ndodh, të ngremë një flamur në cep të taracës. Kur e vumë atje, njerëzit po e shikonin dhe thanë: “Çfarë bëni? Bezja e kuqe tregon luftë, duhet shqiponja!” Mersin Vlashi bëri shqiponjën. Në kohën që e ngritëm flamurin, vjen Bedri Çoku. Ai i foli njerëzve që ishin aty. “Vëllezër, ky është flamuri i vërtetë i shqiptarëve, flamuri i Skënderbeut, i larë me gjakun e shqiptarëve në shekuj, ky është flamuri ynë!”

NEIM PASHA

(Nga dëshmia e ish- të dënuarit politik, Neim Pasha, në kuadër të projektit “Edhe muret kanë veshë”, bashkëpunim i AIDSSH me Kristale Ivezaj Rama dhe Alketa Xhafën)


Sigurimi i Shtetit – Organ i krijuar pas Luftës së Dytë Botërore nga regjimi komunist. Ai organizoi veprimtarinë e tij bazuar në një platformë politike të partisë në pushtet dhe të pambështetur në ligj. Kjo solli shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Gjatë veprimtarisë së tij u bënë shumë shkelje ligjore. Ai vuri në survejim gjithë sektorët e jetës së vendit, kuadrot dhe njerëzit e thjeshtë, zbatoi praktika të padrejta dhe tejkaloi kompetencat, sidomos në kuadrin e luftës së klasave dhe të nxitjes artificiale të saj. (Sipas të dhënave nga faqja zyrtare e Shërbimit Informativ të Shtetit).

Bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit – Është çdo person që vërtetohet se ka bashkëpunuar në mënyrë të fshehtë me organet e ish-Sigurimit të Shtetit në veprimtari të karakterit politik, që lidhen me veprat penale politike. (Sipas nenit 3, pika 4 e Ligjit 45/2015 i ndryshuar).

Dokumente të Ish-Sigurimit të Shtetit – Janë të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, veçanërisht, por pa u kufizuar: dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera; riprodhimet, kopjimet e tyre dhe publikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore; si dhe mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave; dokumentet e gjykatave dhe të prokurorive, për aq sa disponon fondi i ish-Sigurimit të Shtetit; disa dokumente të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, sipas disa përcaktimeve ligjore. (Sipas nenit 3, pika 5 e Ligjit 45/2015 i ndryshuar).

SIGURIA DHE RRETHIMI I BURGUT

Edhe pse pozita gjeografike ishte e tillë që nuk favorizonte arratisjen e të dënuarve politikë, burgu i Spaçit si një objekt i rëndësishë së veçantë dhe sigurisë së lartë, kishte një rrethim të dyfishtë me tela me gjemba. Në shtylla ishin të vendosura prozhektorë me qëllim ndriçimin e zonës gjatë natës. Rrethimi i madh, përfshinte burgun, galeritë e minierës dhe malin. Ai ndërpritej nga rreth 30 kulla vendroje që qheshin karakollë. Rrethimi më i vogël ndante zonën e të burgosurve me administratën e burgut. Pikërisht jashtë këtij rrethimi qëndronin birucat, për të shpëputur kontaktin e të izoluarve me pjesën tjetër të të burgosurve. Kampi ruhej nga ushtarë të përgjegjedhur që kryenin shërbimin ushtarak. Në kuadër të sigurisë ishin menduar edhe plane të tjera mbrojtjeje në zonat pranë kampit, në rast arratisjeje të të burgosurve.




Harta e rrethimit të burgut të Spaçit. Objekt nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit.

Katër të burgosur të përfshirë në revoltë u dënuan me vdekje, me akuzën për terrorizëm. Vendi i ekzekutimit të dënuarve Pal Zefi, Skënder Daja, Hajri Pashaj dhe Dervish Bejko nuk dihet. Trupat e tyre nuk janë gjetur as sot. Dëshmitarët rrëfejnë se fotot e katër viktimave iu treguan një ditë më pas të burgosurve në Spaç për të ushtruar presion dhe për të treguar se kushdo që do të ngrinte krye, do të ndëshkohej.

“Më kujtohet Skënder Daja kishte hipur në taracë, kishte marrë kitarën që ma kishte sjellë Vaçe Zela dhe më thoshte që të mos dorëzoheshim se do të na pushkatonin të gjithëve.”

GËZIM ÇELA

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)



Faksimile e vendimit të gjyqit për dënimin me pushkatim të 4 protagonistëve të revoltës së Spaçit. Objekt nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit.




Foto e ish - të dënuarit politik Skënder Daja, njërit prej 4 të pushkatuarëve të revoltës së Spaçit. Objekt nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit.



OBJEKTE
DËSHMI, FAKTE



Fakte për

SPAÇ

PUNË E DETYRUAR

Në Prill 1968 në burgun e Spaçit mbërritën të dënuarit e parë politikë. Në parim ai duhet të ishte vetëm një burg, por në fakt Reparti i Riedukimit 303 u vendos pranë minierës qëllimisht, për të shfrytëzuar me detyrim të burgosurit politikë si forcë pune. Kapaciteti fillestar ishte 504 vetë, por aty u vendosën mbi 1000 të dënuar politikë. Ata duhet t'i nënshtroheshin punës së rëndë dhe të detyruar për të nxjerrë bakër dhe pirit, fillimisht në 3 zona dhe më vonë në 5 zona të minierës.



Trupat e betonit që përforconin galeritë e minierës në Spaç, pjesë e Memorialit "Postbllok" në Tiranë.




Vagon miniere në Spaç.

NJË DITË PUNE PËR TURNIN E PARË

- 05.30 ● Zgimi dhe larja, nevojat personale
- 06.00 ● Mëngjesi
- 07.00 ● Përgatitja për punë
- 15.00 ● Puna në minierë dhe kthimi në kamp
- 17.00 ● Rreshtimi për të ngrënë, dreka dhe larja e enëve
- 17.10 ● Apeli, rreshtoheshin në tarracë para pallatit dhe bëhej numërimi nga rojet
- 17.15 ● Leximi i shtypit dhe i materialeve propagandistike të Partisë së Punës
- 18.00 ● Kohë e lirë, lëvizje në kamp brenda zonës së lejuar
- 19.00 ● Ngrënia e darkës dhe lajmet
- 21.00 ● Gjumi

DHUNA FIZIKE

Kur një i dënuar nuk realizonte planin ose thyente rregulloren, për shembull; largohej nga fronti i punës, ose mbante sende të ndaluara ai prangosej dhe i nënshtrohej dhunës fizike. Mjetet e tjera, shkopi i gomës, zinxhiri, etj përdoreshin gjithashtu për të torturuar të dënuarit. Për t'i shpëtuar shtrëngimit të duarve, shumë të burgosur hapnin parakrahët fort, në mënyrë që polici të mos kishte mundësi të çonte hekurat deri në fund, duke krijuar një hapësirë te kyçet. Kështu shmangej dhimbja nga shtrëngimi i prangave. Sipas dëshmitarëve, këto lloj prangash quheshin pranga gjermane dhe shtrëngoheshin aq fort sa shkaktonin gjendje të fikti te të dënuarit.



“Na morën, na lidhën me zinxhirë në seri, në këmbë dhe në duar, madje edhe në gojë që të mos flisnim”

NEVRUZ GOLKA

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)

Plani për nxjerrjen e bakrit dhe piritit përcaktohej nga komanda dhe norma ditore njoftohej çdo ditë gjatë apelit. Plotësimi i normës dhe për pasojë realizimi i planit ishte një kusht i padiskutueshëm për drejtuesit e kampit. Norma ditore për një vagonist ishte 4 vagonë për prodhimin. Një vagon pirit ishte 2 tonë dhe një vagon bakër, 1,5 tonë. Në rast të mosrealizimit të normës, të dënuarit ndëshkoheshin dhe mbylleshin në birucat e izolimit.

Çdo i dënuar që realizonte normën paguhej me 10% të pagës së një minatori në liri. Në vitin 1953 kur realizonte normën 100%, i burgosuri kishte të drejtën e uljes së dënimit me 0.02 ditë në muaj dhe një pagesë që nuk kalonte 35% të vlerës së kryer. Në rast të mosrealizimit të normës, i zbritëj pagesa në proporcion të kundërt. Në korrik 1968 u hoq shpërblimi me pagesë dhe zbritje të ditëve në burg, për ata të dënuar politikë që kalonin planin me 25% duke argumentuar se puna e detyruar nuk po shërbente për riedukim, por për përfitime personale.

Nga viti 1968 deri në vitin 1990, rreth 2000 të dënuar dhe të ridënuar kanë punuar në kampin e Spaçit. Nga shfrytëzimi i punës së tyre janë prodhuar në këto vite, 2.82 milionë tonë bakër dhe 1.3 milionë tonë pirit. Në vitin 1981, falë punës së të burgosurve politikë, prodhimi i bakrit u rrit me 4 herë, rreth 200 mijë tonë në vit.

USHQIMI

Menjëherë pas mbërritjes në kamp, të dënuarit i jepnin enët e ushqimit, një tas dhe një lugë. Enët e tjera që përdoreshin nga të burgosurit silleshin nga familjarët. Ushqimi ishte gjellë me barishte, lakër, presh, spec, oriz, fasule (më rrallë) dhe makarona, ndërsa në mbrëmje çaj me djathë, ose marmelatë molle. Higjiena në mensë mungonte plotësisht, vaktet shpesh ishin të pagatuara mirë dhe me papastërti. Uji i pijshëm ishte i ndotur nga mineralet e nëntokës.

“Ngrihesha në mëngjes në orën 5, laja sytë, merja tasin e lugën dhe vija në mensë, haja bukën dhe çoja tasat në vend. Ushqimi ishte: fillonte me domate, mbaronte domatja, fillonte speci mbaronte speci, fillonte preshi i njomë, mbaronte preshi i njomë, preshi i thatë ishte tërë krimba, por do ta haje nga e keqja.” ILIAZ KAJA

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)

MBIJETESA

Për t'i shpëtuar presionit të fortë fizik dhe psikologjik, lodhjes, keqtrajtit, mallit dhe vuajtjes shpirtërore, të dënuarit gjenin të gjitha format e mundshme të ushtrimit të profesionit që kishin para se të dënoheshin. Ata bënin edhe punime artistike. Publiciti Fatos Lubonja gjatë qëndrimit të tij në burgun e Spaçit, gdhendi disa objekte artistike me bërthama pjeshke apo kuti të veshura me farat e frutave dhe të lustruara.

Gjuha e huaj ishte e ndaluar, por mësohej në fshehtësi. Nëse gjatë kontrolleve gjendeshin libra, të dënuarit ndëshkoheshin me izolim në birucë. Krijimtaria letrare e shkruar edhe në letra cigaresh si në rastin e publicistit Lubonja, fshihej ose në brendësi të dyshekut të kashtës, ose në galeri. Sipas dëshmisë së ish të dënuarit politik, Agim Hoxha, shkrimtari Zyhd Morava i fshihte krijimet e tij në një tub që gjente në galeri. Ai e shtypte në një anë tubin dhe nga ana tjetër e taposte me leckë. Dhe këtë tub të shndërruar në një shishe e fuste në hapësirat e trupave të galerisë. Para revoltës, të dënuarit kishin një orar të shkurtër të konsideruar si kohë të lirë që shërbente për të luajtur shah ose domino.



Kandil me karbit që përdorej nga të dënuarit në minierë. Objekt nga arkivi i publicistit Fatos Lubonja.



Pjata dhe luga e një të burgosuri në Spaç. Objekt nga arkivi i publicistit Fatos Lubonja.



Tenxhere me të cilën kanë gatuar të dënuarit politikë në Spaç. Ylber Merdani dhe Ali Fazolli. Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.



Gota me të cilën ka pirë çaj para pushkatimit, Pal Zefi. Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.



Punim me bërthamë pjeshke, realizuar në burg nga publicisti Fatos Lubonja.



Libër i shkruar në fletë cigare në kohën e burgut nga publicisti Fatos Lubonja.

DËSHMI

“Nuk pranova të punoj më edhe bëra katër muaj birucë, bëra 1 ditë grevë urie. Më sollën prokurorin edhe i thashë: “Këta thonë je i dënuar me vdekje, por unë nuk jam i dënuar me vdekje. Pse më thonë po nuk dole në punë do vdesësh?” Unë isha në rregull se nuk ishte punë e detyruar me vendim gjykate.” FATOS LUBONJA

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)



VESHJET

Bashkë me enët, jepeshin edhe rrobat e burgut. Uniformat ngjyrë kafe dhe një tjetër uniformë blu me vija kafe dhe të bardhë, të cilat ishin për stinën e verës. Ishin gjithashtu 2 këmisha, 2 palë benevrekë të gjata, pece për këmbët dhe një peshqir. Për dimrin jepeshin kapotat ushtarake të lyera me bojë të zezë, 4 batanije, dyshek kashte, 2 çarçafë, 2 këllëfë dhe jastëkun kashtë. Edhe në stinën e dimrit të izoluarve në biruca u lejonin vetëm veshjet verore pavarësisht temperaturave nën zero. Për të siguruar veshje të tjera, kishte të dënuar të cilët bënin triko, kapele, çorape leshi me shtiza. Nga shtëpia lejoheshin të sillnin vetëm ndërresa dhe sendet që ishin jetike si syzet me numër, por jo syze dielli.



Veshje verore të një të burgosuri në Spaç. Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.

“Kur mbërrije të çonin te magazina për të marrë teshat e burgut që ishin ngjyrë kafe, merrje dyshekun prej kashte, Në një dhomë ishim 50 vetë.” AGRON HOXHA

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)

DËSHMI

“Kam ndenjur në birucë, një muaj vetëm sepse kisha lexuar librin me fabulat e Ezopit. Unë po mundohesha të mësoja disa fjalë në frëngjisht nga “Gjinkalla dhe miligona”, kur ma gjeti polici. Ishte një libër shumë i vjetër që kishte kaluar dorë më dorë.” MUSA HOXHA

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)